

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

RRITJE INTENSIVE E PESHKUT




Impiant për rritjen e peshkut me kosha notues

Porositësi : SUBJEKTI “ALIE – B” SARANDË

TË DHËNAT PËR SUBJEKTIN

Të dhënat për kompaninë **“Alie - B” sh.p.k.** me administratorë **z. Andrea Boçi** janë marrë nga Ekstrakti i Regjistrimit Tregëtar për subjektet Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, dhe në formë të përmbledhur janë si më poshtë :

- Numuri Unik i Identifikimit të Subjektit (NIPT) **K33709802L**
- Data e regjistrimit **01.01.2003**
- Emërtimi i subjektit **ALIE – B**
- Forma ligjore **sh.p.k.**
- Data e themelimit **31.05.2001**
- Selia **Metoq, Sarandë**
- Veprimtaria **Impiant për rritjen e peshkut me kosha notues Gjiri I Baxhos, Njësia Administrative Lukovë, Bashkia Himarë**
- Vendndodhja e veprimtarisë



Vendndodhja e koshave në det

Te dhënat baze

SIPËRFAQJA TOTALE UJORE QË ADMINISTRIN: **4,4 ha**

NGA KËTO:

- SIPËRFAQJA QË SHFRYTËZOHET PËR INSTALIMIN E KOSHAVE **0,85 ha**

Ky projekt synon të zhvillojë aktivitetin e akuakulturës me kosha notues në Detin Jon në jug të Shqipërisë në Gjirin e Baxhos , Njësia Administrative Lukovë, Bashkia Himarë , Qarku Vlorë.

Ky është një investim i kryer nga kompania **“Alie -B” sh.p.k.**

Të dhëna teknike për projektin

Në këtë kapitull do të bëhet një përshkrim shumë i shkurtër i projektit teknik pasi hollësitë janë në **“Raportin teknik të projektit”**, i cili ishte pjesë e dokumentacionit për miratimin e **Vendimit për VNM-në paraprake**,

Subjekti juridik **“ALIE – B” sh.p.k.**, do ta kryej aktivitetin e saj **“Kultivimi me kosha i kocës dhe levrekut”** në vendin e quajtur Gjiri i Baxhos , Njësia Administrative Lukovë , Qarku Vlorë.

Aktiviteti do të kryhet në ujërat e detit Jon , në një sipërfaqe ujore totale prej 4, 4 ha , në të cilën do të shfrytëzohet vetëm 0,85 ha për instalimin e koshave me distancën më të afërt nga ana e detit që fillon nga 300 m dhe në thellësi që varjon nga 40 m deri në 50 m

Kapacitet e parashikuar janë 450 – 500 ton në vit.

Kjo zonë ndodhet në kufi me Bashkinë Sarandë e vendosur në pjesën veriperëndimore të qytetit të Sarandës, rreth 4 km nga kufiri fundor I këtij qyteti.

Qëllimi kryesor i kësaj veprimtarie është:

- kultivimi i llojit të kocës dhe levrekut me kosha notues në det të hapur dhe paketimit të tij për marketing.

Në përzgjedhjen e llojeve të specieve që kultivohen në këto kosha janë marrë në konsideratë:


- Kërkesa e tregut për lloje specifike
- Klima e zones
- Cilësia e ujit pasi ujërat e Jonit mbështesin natyrisht jetesën e këtyre llojeve me resurset e nevojshme

Dy janë llojet kryesore të peshkut që kjo kompani synon të kultivojë :

1. Levreku (Dicentrarchus labrax)
2. Koca (Sparus aurata)

Zona detar ku do ushtrohet aktiviteti (sipas kontratës me Ministrinë e Mjedisit)
ka këto kufizime:

- Veriu sipërfaqe tokësore kullotë
- Jugu sipërfaqe ujore detare
- Lindja sipërfaqe tokësore (baxhua e vjetër)
- Perëndimi sipërfaqe tokësore dhe ujore



Planimetria e vendndodhjes së koshave në det

LEGJISLACIONI

Përmbledhje e bazës ligjore për menaxhimin e mjedisit

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Ndër më specifikut po përmendim:

Ligje

- Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”
- Ligji nr.10 440, datë 07.7.2011 Për vlerësimin e ndikimit në mjedis “
- Ligji nr.10 463, datë 22.9.2011”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
- Ligji nr. 9115 datë 24.07.2003“Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006“Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
- Ligji Nr.8906, datë 06.06.2002 , ndryshuar me ligjin Nr. 9868, date 04.02.2008 “Për zonat e mbrojtura”
- Ligji nr. 93 85 datë 04.02.2005 ndryshuar me ligjin nr 9791 datë 23.07.2007, ndryshuar me ligjin nr. 36/2013 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”
- Ligji nr. 9334 datë 16.12.2004 “Për aderimin e Shqipërisë në Protokollin e Kiotos, në Konventën për Ndryshimet Klimatike”
- Ligji nr. 9774 datë 12.07.2007 “Për administrimin e zhurmës”

Vendime Të Këshillit të Ministrave

- VKM nr. 435 datë 12.09.2002 “Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- VKM nr.177 datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”
- VKM nr. 804 datë 04.12.2003 “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihet në mbrojtje
- VKM nr. 247 datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave , të kërkesave e të procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”
- VKM nr.686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”

Udhëzime

- Udhëzim nr. 8 datë 27.11.2007 “Për nivelin kufi të zhurmave në mjedis të caktuar”

Legjislacioni Ndërkombëtar

Shqipëria është nënshkruese e një numri të madh konventash dhe marrëveshesh mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, duhet që kuadri ligjor shqiptar të përshtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel rajonal dhe ato të BE-së dhe më poshtë ilustrohen në mënyrë të përmbledhur etapat kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit, nëpërmjet një kuadri të përmbledhur të qëllimeve kryesore të programeve komunitare dhe direktivave kryesore që rrjedhin nga një sektor i tillë.

Raporti i VNM-së për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përfaqësojë pjesë të tij me legjislacionin e BE-së mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm.

Disa nga Konventat dhe Protokollet e ratifikuara nga Shteti Shqiptar

Konventa:

- Konventa Aarhus “Për akses në informacion, pjesëmarrje të Publikut në Vendimmarrje Ambientale dhe akses të drejtësisë në Çështjet Ambientale” të ratifikuar me ligjin nr. 8672 datë 26.10.2000 “Mbi ratifikimin e Konventës së Aarhusit”
- Konventa ESPPO “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në konteks ndërkufitar” , Finlandë datë 25.02.1991
- Konventa “Për ndotjen atmosferike në distanca të mëdha” , Gjenevë , Zvicër , datë 13.11.1979
- Konventa “Për ruajtjen e Florës dhe Faunës së egër dhe Mjedisit Natyror të Europës” Bërn, 19.09.1979
- Konventa e Stockholmit” Mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm”

Protokolle:

- Protokollin e Kievit, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, Ratifikuar me ligjin nr. 9424 datë 06.10.2005 “Për ratifikimin e Protokollit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor” si dhe e reflektuar në ligjin 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”
- Protokollin e Kartagjenës “Për biosigurinë”, bërë palë në vitin 2005
- Protokollin e Kartagjenës “Për sigurinë biologjike”, Ratifikuar në vitin 2004.
- Protokollin e Kiotos “Për ndryshimet klimaterike” ratifikuar me Ligjin nr. 9334 datë 16.12.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos”
- Ligji nr. 9548 datë 01.06.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin për Regjistrat e Shkarkimit dhe transferimit të Ndotësve”

Peshkimi ndërkombëtarë, instrumentat dhe marrëveshjet që lidhen me të orientojnë vendet kufitare në menaxhimin e zhvillimin e sektorëve të tyre të peshkimit. Instrumentat e mëposhtëm dhe marrëveshjet janë në veçanti të lidhura me menaxhimin e peshkimit në Shqipëri:

- 1982 Konventa e OKB për Ligjin e Detit (ratifikuar në Qershor 2003)
- 1995 Kodi i FAO Kodi i Sjelljes për Peshkimin e Përgjegjshëm (implementuar si një kod vullnetar në 1997)
- 1993 FAO Marrëveshja e Zbatimit (pranuar në Maj 2005)
- Komisioni i Përgjithshëm i Peshkimit për Mesdheun (GFCM) (ratifikuar në korrik 2003)
- 1957 Komisioni Këshillmor i Peshkimit të Ujërave të brendshëm (EIFAC).

Qëllimi i hartimit të raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Qëllimi kryesor i përgatitjes së Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është të identifikohen ndërthurjet e mundshme të projektit me mjedisin fizik e social dhe me politikat e mbrojtjes së mjedisit për zonat ku do të zbatohet projekti.

Më konkretisht, ky dokument ka për qëllim:

- Të minimizojë streset në mjedis dhe mbi njerëzit dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e shëndetit human, tokës, kontrolli i ajrit, dhe ruajtja e cilësisë së ujit.
- Të fokusojë problemet mjedisore si kyçe për planifikimin e zhvillimit të veprimtarive duke promovuar kuptimin më të mirë të marrëdhënieve ndërmjet masave për përdorimin e tokës, objekteve ekzistuese dhe infrastrukturës specifike si transporti ose menaxhimi i mbetjeve urbane dhe industriale dhe ndikimi i tyre mjedisor, social dhe ekonomik
- Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë mjedisin njerëzor, faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.
- Të evidentojë pikëprerjet dhe bashkërendimin e projektit me kuadrin rregullator legjislativ kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit.
- Të identifikojë statusin mbrojtës të zonave ku do të zhvillohet projekti
- Të përshkruajë vlerat natyrore dhe mjedisore në zonën e projektit.
- Të identifikojë ndikimet e mundshme thelbësore negative në vlerat natyrore dhe në mjedis duke propozuar njëkohësisht masat për zbutjen e tyre dhe mbrojtjen e mjedisit nga këto ndikime.
- Të lehtësojë vendimmarrjen e organeve kompetente planifikuese dhe mjedisore për projektin.

- Të kontribuojë në një proces më transparent të hartimit të projektit duke përfshirë publikun dhe aktorët e tjerë vendimmarrës.
- Të rrisë kapacitetin administrativ të njësive të qeverisjes vendore, kooperimin dhe efikasitetin e sistemit të planifikimit.
- Të identifikojë kufizimet, mundësitë dhe resurset mjedisore të zonës të cilat do të influencojnë mbi mënyrën se si duhet të hartohen propozimet për zhvillimin e projektit.
- Të harmonizojë ndikimet dhe përfitimet, pra efektet e kombinuara të propozimeve të ndryshme për zhvillimin e veprimtarive të propozuara me veprimtaritë ekzistuese dhe të projekteve dhe planeve të tjera

Në bazë të Ligjit nr.10431 dt 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, neni 3 i tij, citojmë objektivat e mbrojtjes së mjedisit.

- Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit
- ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike
- përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj
- ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror
- mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit

Studimi dhe vlerësimi i efekteve mjedisore është një moment i rëndësishëm i ciklit të zhvillimit të një projekti. Studimi mund të kryhet njëkohësisht ose paralelisht me procesin e planifikimit të projektit dhe prezantohet si më vete ose si pjesë e studimit të besueshmërisë. Hartimi dhe zhvillimi i një projekti të qëndrueshëm lidhet me kompleksitetin e projektit, mënjanimin e streseve mjedisore të mundëshme, ndjeshmërinë e komponentëve mjedisor të zonës ku do të zbatohet dhe masat që do të ndërmerren për vëmendje të veçantë do të kushtohet projekteve që shkaktojnë efekte mjedisore negative të dukshme siç mund të jenë ndërtimi i impianteve industriale që shoqërohen me emetime, veprat e infrastrukturës (rrugë të reja) që shoqërohen me efekte që është shumë e vështirë të identifikohen, efekte që vijnë si rezultat i rritjes së aksesit ndaj burimeve si dhe projekte që intereferojnë me ekuilibrin natyror të natyrës.

Në rastet e implementimeve të projekteve të ndryshme me impakte në mjedis, aspektet më të rëndësishme mjedisore që duhen konsideruar në zonën ku do të zhvillohet projekti janë:

- Situata aktuale mjedisore dhe evidentimi i ekosistemeve specifike
- Problemet ekzistuese mjedisore dhe gjendja e ekosistemeve të ndryshme në rast se projekti nuk zbatohet.
- Përshkrimi i efekteve mjedisore të shkaktuara nga projekti dhe alternativat
- Vlerësimi i stresit të përgjithshëm mjedisor në të ardhmen
- Ndërveprimi i efekteve ekologjike, ekonomike, sociale dhe kulturore

- Rekomandime për alternativa me efekte negative më të ulëta (metoda alternative, kufizimi i emetimeve, ndotjes në përgjithësi).
- Vleresim të përgjithshëm të situatës mjedisore në prespektivën e zhvillimit dhe funksionimit të projektit.

Të dhënat bazë për projektin

Siç u tha më lart, VNM përfshin një studim të gjerë të të dhënave bazë të kushteve fizike, biologjike dhe kushtet sociale në vendndodhjen e projektit. Teksti i mëposhtëm përmbledh të dhëna të përgjithshme në lidhje me zonën e projektit.

Vetë zona përreth është mjaft komplekse dhe heterogjene ka vlera peisazhore dhe ekoturistike. Por theksojmë se instalimi i aktivitetit në një pozicion mbrojtës dhe jo shumë ndërhyrës mjedisor ka patur parasysh këtë element natyror të zonës. Monumente të trashëgimisë në afërsi të platformës nuk ka, duke mos patur asnjë impakt mjedisor.

Vendi i përzgjedhur për vendosjen e koshave është mjaft i përshtatshëm sepse:

- Deti ka thellësi të mjaftueshme 40m e lartë në vendin ku do të vendosen koshat
- Ekspozimi i zonës është i mirë, drejtimi jugor influencon duke favorizuar zhvillimin e akuakulturës sepse mbrohet nga erërat e zonës.
- Favorizon kushte të mira diellëzimi, kushtet klimaterike dhe regjimi i atmosferës është favorizues për akuakulturën .
- Në këtë zonë ujore vërehet fenomeni i dallgëzimit 5-8 ballë (mesatarisht) duke mos ndikuar në regjimin biologjik të peshqve.
- Temperatura është relativisht konstante, pra me luhate të vogla .
- Aktiviteti nuk krijon ndërhyrje në bioekologjinë e cenozave natyrore ujore dhe tokësore, meqenëse shfrytëzohet hapësirë e lirë detare dhe sipërfaqe stere e lire për vendosjen e mjeteve ndihmëse pa tjetërsuar territore dhe sipërfaqe ujore.

BURIMET FIZIKE

Pejsazhi natyror

Meqenëse aktiviteti i subjektit “Alie – B” sh.p.k. është i vendosur në kufirin që ndanë Njësinë Administrative Lukovë, Bashkia Himarë me Bashkinë Sarandë dhe konkretisht qytetin e Sarandës, po ju referohemi të dhënave të këtij qyteti. Ky aktivitet është i vendosur në pjesën veri – perëndimore të qytetit të Sarandës

Qyteti i Sarandës , është qyteti që shtrihet në J-JP të vendit tonë . Shtrihet në një terren paramalor, midis detit Jon në perëndim dhe terreneve malore të Malit të Sarandës në lindje. Teritori është mjaft

mirë i ekspozuar ndaj diellit dhe detit , është i ndriçuar gjatë gjithë ditës . Deti përbën figurën kryesore të qytetit .

Veçoritë klimaterike që shfaq kjo zonë janë të përshtatshme e të shfrytëzueshme për trajtimin e objekteve me karakter banimi dhe shërbimi.

Gjiri i Sarandës, është një nga më të mëdhenjtë e bregdetit Jon , i cili ka formën e një harku e futet në tokë rreth 1 km. Brigjet janë shkëmbore dhe të larta . Pjerësia e shpatit të kodrave të Gormartit (167.8m) dhe të Berdeneshit (103 m) është mesatare . Në jug të qytetit , shtrihet faqja perëndimore e malit të Lëkurësit . Në perëndim shtrihet veriu i ishullit të Korfuzit , ngushtica e tij me drejtimin V-VP e J-JL. Është e gjatë 34 milje . Pika më e ngushtë rreth 3 milje . Thellësia e kanalit lëkundet rreth 55-70m .

Midis kepit të Paladhës dhe kepit të Varesë në VP, formohet gjiri i Limjonit me gjerësi hyrje rreth 185 m . Mbi këtë sektor ngrihet nje vargmal (me dy maja , ajo e Oftës 507 m dhe e Lasarës 585 m lartësi) i cili zbret me pjerrësi mesatare në bregdet . Qyteti i Sarandës zë një sipërfaqe 2147 ha, dhe ka rreth 41.000 banorë. Laget në një gjatësi të vijës së ujit nga deti Jon 7.5 km, ndërsa kufijtë e tjerë janë të përcaktuar si bashkësi elementesh gjeografik-natyrore e social ekonomik .Rrallë në ndonjë rajon gjenden bregdeti, fushgropa , kodra , lugina , mali , mikro e makroforma interesante të tipit të monumenteve natyrore. Pozita gjeografike ofron edhe disa elementë bioklimatike optimalë e deri specifik .

Zona në studim nuk është e përfshire në mënyrë direkte dhe indirekte në kategoritë (I – VI) të zonave të mbrojtura si rezervat natyrorë e shkencorë, park kombëtar, monument natyror, rezervë natyrore, zonë e menaxhimit të habitateve, peizazh i mbrojtur, zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara apo me përdorim të shumëfishtë.

Zona ku do të implementohet projekti nuk është zonë buferike dhe nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura me interes ndërkombëtar, sipas konventës së Ramsarit, konventës botërore të trashëgimisë, etj.

Klima

Zona ku shtrihet projekti ka një klimë tipike Mesdhetare. Karakteristikë themelore e kësaj lloj klime është dimri i butë e i lagët dhe vera e nxehtë dhe e thatë. Klima është e butë dhe ofron mundësi të mira për një sezon turistik relativisht të gjatë. Për të pasur një pamje më të qartë mbi kushtet klimatike të kësaj zone, më poshtë po shqyrtojmë disa nga elementët kryesorë të klimës:

Erërat:

Shpejtësia mesatare: nga 1.8 m/sek – deri 2.2 m/sek

Shpejtësia minimale: nga 1.4 m/sek – deri 1.6 m/sek

Shpejtësia maksimale: nga 2.2 m/sek – deri 2.4 m/sek

Lagështia e ajrit lidhet ngushtë me temperaturën e ajrit. Relativisht lagështia mujore varion nga 62% deri 69%, ndërsa lagështia relative vjetore është 66%. Zgjatja e diellzimit në të arrin 2500 orë në vit, ndërsa numri i ditëve me diell është rreth 330.

Temperatura mesatare vjetore në zonën e studimit është midis 16.1 - 17.7°C. Në janar temperatura e ajrit është midis 8-10°C, kurse në gusht luhartet midis 24-26° C. Sezoni i plazhit përgjatë bregdetit jugor të Shqipërisë luhartet midis 150 – 180 ditëve (bazuar në numrin e ditëve me temperaturë mbi 20°C).

Flora dhe vegjetacioni ekzistues

Zona në të cilën pozbatohet projekti, është në një sipërfaqe ujore me thellësi mbi 40 m. Është një zonë në të cilën nuk ka zhvillime sociale pasi ndodhet në distance të konsiderueshme nga qendrat e banuara dhe me pak mundësi komunikimi. Është një zonë e veshur me shkurre dhe ku deti Jon ka një pastërti të dukshme. Është pjesë përbërës e kodrave në veri të qytetit të Sarandës. Pjesa e gjirit përmban një plazh të vogël ku mbi pjesën e sipërme të saj pozicioni gjeografik i relievit është i thepisur.

Struktura e tokës në zonë dhe përreth saj është tipike e formacioneve karbonatike të vijës bregdetare të detit Jon. Reliev me tokë të varfër dhe pa burime ujore.

Bregdeti mesdhetar dhe mjedisi shkëmbor kanë shkaktuar zvogëlim apo varfërimin e përberjes floristike, duke e bërë atë një bimësi karakteristike të habitateve hasmo-halofilike, vecanërisht në nivele nga 0-40 m mbi nivelin e detit.

Relievi është pjesë përbërëse e shpatit të kodrave. Është një reliev tipik karbonatik i zhveshur nga bimësi e lartë. Është zonë e pa zhvilluar, tani për tani ka vetëm disa ndërtime të përkohshme që shërbejnë si stane për baqet.

Ky objekt shtrihet në pjesën e bregdetit në Zonën e Baxhos me popullime floristike shumë të varfër, kryesisht bimësi barishtore në gjendje të egër dhe spontane si dhe një sipërfaqe relativisht të vogël të populluar me bimësi shkurre dhe drusore.

Mbi kete baze bimesia e zones perbehet nga:

- **Bimësia e shpatit të malit** e cila ndodhet në kufijtë relativisht më të afërt të zhvillimit të aktivitetit, rreth 150m. Kjo bimësi është tipike kserofite dhe e relievit karbonatik jugor. Zotërohet kryesisht nga valanidhi, dhe tek bimësi e përzier të rralla si bimësi e proit ku grumbullohen më shpesh ujëra të ëmbla dhe pleh shelgje (gj. Salix), ferra (gj. Rubus), driza (p. Aquakultures), vitex agnus si dhe mjaft barishtore dhe shkurreta kserofite.
- **Bimësia e malit** e cila është tipike e formacioneve karstike, pra bimësi kserofite që varion nga poshtë - lartë, nga drutë deri në bimë barishtore tipike malore. Bimësi drunore dallojme (Q. Valeriana) (Q. Colcifera) (Q. ilex)

Në këtë habitat përfshihen gjithashtu lloje faunistike kryesisht intervebrorë të padetrimuar si dhe pak lloje gjallesash të egra sporadike.

Përbërsit më të rëndësishëm të kësaj zone janë shpendët dhe gjitarët. Por edhe insektet, fluturat, amfibët, reptilet, etj janë të pranishëm në këtë zonë.

Vlerat ekoturistike për zonën si pjesë e zonës eko-turistike të gjirit janë shpendët. Si përfaqësues faunistikë të takueshëm përmendim: dhelpra, miu i arave, nuse lala, skifteri, thëllënza e malit etj.

Është mjaft e zhvilluar blegtoria kryesisht bagëtitë e imta që shfrytëzojnë kullotat e pasura në vijimësi e që e favorizon vet relievi, e klima.

Ekosistemi ku ngrihet objekti karakterizohet nga faktorë ekologjikë dhe antropogjen të disfavorshëm për popullime floristike - faunistike natyrore.

Vlerat e parametrave të faktorëve ekologjike fiziko- kimike janë të papërcaktuara nga institucione të specializuara por të pranuar si normale e brenda vlerave të lejueshme.



Flora dhe Fauna detare

Në përgjithësi zona si pjesë e rivjerës së detit Jon karakterizohet nga tendeca e pakësimit të popullatave natyrore të peshkut qoftë për shkak të teknikave të peshkimit por edhe për shkak të ndotjes së përgjithshme. Prurje të drejtëpërdrejta të lumenjeve në zonat më të afërta të gjirit të Baxhos nuk ka, gjithashtu nuk ka shkarkime organike të zonave urbane.

Prurjet natyrore janë nga proskat e shpatit të malit gjatë stinëve me rreshje intensive.

Këto ujëra janë të pasura kryesisht me mbeturina bimore dhe plehërishte pasi zona shfrytëzohet si kullotë (kryesisht bimore)

Fluksi i prurjeve që shkarkohet në det është i bollshëm, në varësi të rreshjeve dhe Intensitetit të tyre.

Përgjithësisht në këtë zonë gjenden të gjithë peshqit më të përhapur të detit Jon përfaqësues sipas njësive taksonomike invertebrorë dhe vertebror, që nga tipi

një qelizor, stadi i organizmave dyshtresore, të tipit sfungjer, celentrat dhe knidar, plantemide nematemide, analide, molusqe dhe qefalopade.

Po kështu ka me shumicë përfaqësues të tipit Arthropoda si krustace (gaforre të ulta dhe të larta). Shpendët detar nuk janë tipik të zonës dhe me habitat specifik për shkak të përmasave të gjirit, por zona vizitohet nga shpendët pa fluks indikues.

Për shkak të sipërfaqes së vogël në studim nuk merr rëndësi inventarizimi i faunës së zonës.

Gjiri si pjesë e detit popullohet nga të gjitha llojet e peshqëve detar. Në këtë zonë lehtësisht dallohen invertebrorët e tipit:

- Moluske si ciklostomat, fisurela, patella dhe litofage
- Ekinodermete si iriqet e detit
- Celenterete si anemonet që popullojnë thellësinë 2-4 m
- Krustace si gaforret e tipit karcinus që gjenden me shumicë.
- Bimësi ujore shtrihet 3-4 m dhe perfaqesohet nga alget e tipeve të ndryshme
- Bentoni është tipik shkëmbor dhe reaktivisht i pasur me lloje të ndryshme peshqish dhe oktapodë.

Fauna dhe flora të pjesës jugore të bregdetit Shqipëtar paraqet interes të veçantë. Habitata të rëndësishme për peshqit konsiderohen edhe livadhet e Posidonias në thellësitë e 4 - 5 m. Këto livadhe janë tepër të rëndësishme për ushqimin e strehimin e një numëri të madh llojesh përfshi peshqit, krustacet dhe invertebrorët.

Livadhet e Posidonia oceanica janë vlerësuar si indikatorë të tjerë të cilësisë dhe shëndetit të mirë të ujërave të detit dhe përdoren si indikatorë të monitorimit.

Si pjesë funksionale dhe strukturale e detit Jon në Baxhos karakterizohet nga ngopje me oksigjen dhe njëkohësisht me përmbajtja të ulët të lëndës organike. Treguesit e përgjithshëm të vlerësimit të zonës detare me ndikim në zhvillimin e faunës detare janë:

- Azoti
- Fosfori
- Temperatura
- Squfuri
- NBO
- Oksigjeni
- PH

Nevoja biokimike për oksigjen e këtyre ujërave rrallë kalon vlerën 2 mg O₂/lit

Karakteristike për ujërat e kësaj zone për shkak të strukturës së relievit përreth është tendenca oligotrofe.

Burimet socialo - ekonomike

Territori dhe popullsia

Rrethi i Sarandës shtrihet në skajin më jugor të Shqipërisë me një sipërfaqe 732 km². Saranda kufizohet me Delvinën, Vlorën dhe Gjirokastrën dhe lidhet me Greqinë përmes kufirit tokësor dhe detar. Rajoni jugor në tërësi dhe zona përreth Sarandës në vecanti, dallohet për diversitetin e habitateve të tyre. Ka pasuri të pashfrytëzuara natyrore, florë e faunë tokësore e detare karakteristike e disa specie unike për nga lloji.

Është rajon me pasuri dhe vlera kulturore e monumentale të antikitetit, me potenciale e resurse të mëdha për zhvillimin e turizmit kulturor, historik e natyror

TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Njësia vendore e Sarandës e cila aktualisht sot përbëhet nga qyteti i Sarandës, me katër lagje me qytetin e Ksamilit si edhe me fshatrat Gjashtë, Metoq, Shelegar, Çukë, Berdenesh dhe Manastir. Popullsia civile e saj është rreth 54.500 banorë, nga e cila 50.6 % meshkuj dhe 49.4 % femra. Qyteti i Sarandës ka 34106 banorë, ose 63 % të popullsisë së njësive vendore dhe kurse pjesa tjetër ndodhet në Ksamil dhe në zonën rurale.

Në periudhën e verës numri i popullsisë shkon në rreth 100.000 – 120.000 banorë. Gjatë 20 vjetëve të fundit është karakterizuar nga një lëvizje e lartë demografike.

Njësia Administrative Lukovë, si pjesë e Bashkisë Himarë, e përbërë prej 9 fshatrash, shtrihet thuhet tërësisht në bregdetin e Jonit në një gjatësi prej 35 kilometrash, ku në të derdhen ujrat e lumit të Borshit dhe të Bunecit dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 150 000 ha.

Terreni kryesisht kodrinor i territorit ka favorizuar frutikulturën dhe veçanërisht kultivimin e ullirit. Kjo Njësi Administrative ka një popullsi prej rreth 10 000 banorësh që krahas turizmit llogarisin ndër aktivitetet e rëndësishme ekonomike përpunimin e ullirit, ndërtimtarinë, etj

Banorët janë të vendosur në fshatrat Lukovë, Borsh, Fterrë, Çorraj, Piqeras, Sasaj, Qazim Pali, Shën Vasil dhe Nivicë.

INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË TIJ

Territori i rajonit të Sarandës, përshkohet nga lumenj e disa përrenj. Ndër to arterja më kryesore e rajonit është lumi i Bisticës, Kalasës dhe i Pavllës të cilët shërbejnë si ujëmbledhës për të gjitha ujërat e arterjeve dytësore si përrenj e prrocka të vogla. Ujërat që rrjedhin në këta lumenj e përrenj sjellin materiale të shumta në gjithë ultësirën e depresionit, duke bërë dhe një mbushje të saj. Për këtë fenomen dëshmon dhe ndryshimi i kuotës me rreth 30-40m e më shumë në rrëzën e maleve në drejtim të buzës së liqenit të Butrintit, ato zvogëlohen në mënyrë të ndjeshme. Në rrjetin hidrografik

të rajonit veç lumenjeve e përrrenjeve dhe liqenit të Butrintit , me shumë rëndësi janë burimet natyrore të shumta me ujra të bollshme.

Vlen të theksohet se në pjesën veriore e lindore ku strukturat ndërtohen nga shkëmbinj karbonatik , fenomeni i karstit është shumë i zhvilluar dhe dalin burime të fuqishme si ai I Bisticës , Kalasës , e të tjerë . Rrjeti hidrik sipërfaqësor në përgjithsi është i zhvilluar dobët në shpatin perëndimor të Malit të Sarandës. Mungojnë format e larmishme me një evolucion të përshpejtuar , qe lidhet me shkaqe tektonike dhe lokale . Në këta sektor takohen disa prroska me prurje të vogla uji dhe në mënyrë periodike gjatë periudhës së reshjeve të bollëshme (ne depozitimet gelqerore infiltron rreth 45% e sasisë së rreshjeve , ndërsa pjesa tjetër krijon rrjedhje sipërfaqësore) .

Zona ku do të implementohet projekti është në afërsi të qendrës së qytetit të Sarandës. Zona në fjalë nuk karakterizohet nga prania e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij.

Kushtet Hidrologjike

Nga pikëpamja hidrogeologjike, rajoni bregdetar bën pjesë në pellgun e madh artizan të Ultësirës Perëndimore, e kushtëzuar nga përhapja e shkëmbinjve me veti të mira dhe mesatare kolektore (zhavorre dhe konglomeratë) dhe nga kushtet e favorshme klimatike me reshje rreth 1000 mm/vit. Karakteri i ndryshimeve të theksuara stinore dhe shumëvjeçare në regjimin e reshjeve, pasqyrohet edhe në lëkundjen e rrjedhjes ujore.

Prurjet më të mëdha të zonës në studim, kanë më tepër prejardhje shiu dhe shumë më pak karakter të përzier (shiu dhe bore). Plotat me prejardhje shiu formohen kryesisht gjatë fazes së parë të periudhës së lagësht të vitit (Nentor ÷ Mars)

Përveç faktorëve klimatikë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në madhësinë e prurjes më të madhe, një rol me rëndësi luajnë dhe faktorët e tjerë, si p.sh. relievi i pellgut shimbledhes, bimësia, ashpërsia e terrenit, përshkushmëria e tokës, forma dhe madhësia e pellgut shimbledhës.

Në territorin në studim sistemi i kullimit dhe drenazhimit të ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësorë mungon ose nuk është i mjaftushëm.

ANALIZA E NDIKIMIT NË MJEDIS

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis hyn në mardhënie të kushtëzuar ose jo me të, të detyruar ose fakultative, me veprim afatshkurtër ose dhe afatgjatë të cilat duhet të njihen, të vlerësohen, të merren në konsideratë dhe të përcaktohen masat e duhura për minimizimin ose edhe eliminimin e tyre.

Kjo ka rëndësi me qëllim që çdo aktivitet jo vetëm të mos e dëmtojë mjedisin por të jetë sa më paqësor me të, madje të influencojë mundësisht pozitivisht në zhvillimin e ekosistemeve natyrore Praktikisht aktiviteti për kultivimin, rritjen dhe tregëtimin e peshkut nuk shoqërohet me problem mjedisore

Ndikimet mjedisore të vlerësuara si me impakt negative janë gjatë fazës së ndërtimit të koshave notues të cilat janë kalimtare dhe gjatë funksionimit nëpërmjet përdorimit të përbërësve kimikë të ndryshëm si antibiotikë dhe medikamente të ndryshme, apo elementë ushqyes të konservuar. Impakti negativ mjedisor vlerësohet në nivele të ulëta duke qenë se është një aktivitet për rritjen dhe kujdesin shëndetësor të gjallesave ujore. Shfrytëzimi i rezervatit në kushtet e një regjimi të përpiktë pune nuk sjell asnjë impakt mjedisor negativ. Më poshtë kemi paraqitur në mënyrë të përmbledhur ndikimet e mundëshme në mjedis dhe shkalla e indentifikimit të tyre.

Matrica e ndikimeve më të rëndësishme (pozitive dhe negative)

Lloji I ndikimi	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	po	jo	po	jo
NDIKIMI NGA ZHURMAT				
• Rritia e nivelit ekzistues të zhurmave	+			+
• Rritia e nivelit të zhurmave nga punimet	+			+
• Ndikimi I nivelit të zhurmave në faun		+		+
• Ndikim i i zhurmave në migrimet e ndryshme		+		+
• Ndikimi I zhurmave të aktivitetit jetësor të faunës ekzistuese	+			+
NDIKIMET NË FLOR DHE FAUNË				
• Shaktërrim të habitateve natyrore		+		+
• Coptim ose izolim të habitateve të egra		+		+
• Mundësia për migrim të peshqëve natyrore	+			+
• Ndrivshimi i rrugë kalimit të shpendeve		+		+
• Ndyrshim në llojeshmerinë e kafsheve dhe bimeve		+		+
• Ulje të sipërfaqes së kulturave bujqesore		+		+
• Nderhyrje në kullota		+		+
NDIKIMET NË MJEDISIN UJORË				
• Shkarkime ndotese në uie	+			+
• Ndikim në ikiofaunen natyrore		+		+

<ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimi i parametrave të ujit • Ndryshime mekanike të shtratit • Ndryshime në rriedhjen e burimeve nëntokesore • Ndryshime në rruget e rriedhjes së ujrave • Ndryshime në rrjedhjen e burimeve sipërfaqesore, ndryshime në sasinë e ujit të destinuar për publikun 		+	Ndryshime relative	
		+		+
		+		+
		+		+
		+		+
NDIKIME NË CILËSINË E AJRIT				
<ul style="list-style-type: none"> • Prodhim i lendeve dekompozuese • Shkarkime të ndryshme atmosferike • Arome e pakëndeshme 		+		+
		+		+
		+		+
NDIKIME NË PEJSAZHIN NATYROR				
<ul style="list-style-type: none"> • Prishje apo ndryshim të peisazhit eksistues • Ndryshim apo demtim të zonave me vlerë trashgimie natyrore • Demtim i vlerave ekoturistike 	+		+	
		+		+
		+		+
NDIKIM NË SHËNDETIN E BANORËVE				
<ul style="list-style-type: none"> • Ndikim në shëndet nga burimet ushqimore • Ndikim në shëndet nga puna në vaska dhe përreth tyre • Krijimi i burimeve ndotëse njëzore direkt ose indirekt 		+		+
		+		+
		+		+

Duke u bazuar edhe në tabelat e mësipërme, arrihet në konkluzionin se ndikimi në mjedis të këtij aktiviteti do të jetë vetëm në mjedisin ujor. Në mjedisin tokësor ky aktivitet nuk ka ndikime ose janë minimale deri në të papërfillshme dhe përse i përket cilësisë së ajrit, nuk ka çlirime të gazeve të ndryshme, pluhurave, zhurmave, etj.

Ndikimet në mjedisin ujor do të jenë kryesisht në:

- Pakësimin e oksigjenit të tretur në ujë, për shkak të aktivitetit jetësor të peshqve, ndryshimi i Nevojës Biologjike për Oksigjen (NBO) dhe shtimi i lëndës organike në këtë zonë. Kryesisht për

sasinë e ushqimit të cilën peshqit nuk arrijnë ta konsumojnë në kohë dhe penetron në fund të detit, por është prezente edhe faktori I ngordhjes së gjallesave për shkaqe të ndryshme.

- Një sasi jo e vogël e peshqve gjatë ciklit jetësor të tyre ngordhin për shkaqe nga më të ndryshmet. Një nga shkaqet është edhe pamundësia për t'u ushqyer gjatë kohës që hidhet ushqim, dëmtimet fizike gjatë përpjekjeve për të arritur ushqimin të parët, por edhe rastet e sëmundjeve të ndryshme të cilat mund të prekin këto gjallesa. Natyra e peshqve është e tillë që edhe pasi një pjesë e tyre ngordhin për shkaqe të ndryshme, ato janë gjallesa që ushqehen brenda llojit, që do të thotë se me peshqit e ngordhur mund të ushqehen të tjerët ose mund t'i hanë më të rriturit.
- Aplikimi i mjekimit të tyre në raste të infeksioneve të ndryshme ndonëse mund të aplikohet në ushqim, në një përqindje të caktuar dekantoni në fund të detit ose tretet në ujë, çka përben një lloj ndotjeje për mjedisin ujor në nivel lokal.
- Duke pasur një aktivitet të tillë në këtë zonë, ndonëse është në largësi nga bregu I detit, vlerësohet të ketë një frekuentim edhe nga gjallesa të tjera të egra të zonës, si peshq të llojeve të ndryshme, grabitqarë apo edhe gjallesa të tjera të cilat mund të tërhiqen nga prezenca e ushqimit në këtë zonë, që mund të përbejë një migrim të gjallesave ujore.
- Prezenca e këtyre gjallesave të egra në afërsi të koshave lundruës mund të shkaktojë edhe efekte anësore për akuakulturën në vlerësim. Prezenca e tyre mund të ndikojë në pakësimin ose varfërimin e ujit me oksigjen, konsumimin e ushqimit të tepërt që del nga koshat dhe njëkohësisht mund të jenë edhe karrem I grabitqarëve që ushqehen me këto lloj gjallesash.
- Për këto efekte, akuakultura mund të ndikohet në pakësimin e oksigjenit të tretur, ndërsa për ushqimin dhe mbrojtjen nga grabitqarët, janë të siguruara nëpërmjet rrjetave.
- Pastrimi I këtyre rrjetave përben një proces pune më vete, I cili kërkon kohën dhe kushtet e veta. Rrjetat, sidomos gjatë periudhës së verës, mund të mbushen me alga dhe myshqe të ndryshme dhe këto të fundit, kthehen në pengesë për qarkullimin e ujit.
- Ndër të tjera në këtë sipërfaqe ujore vlerësohet edhe rritja e përqendrimit të jashtëqitjeve të këtyre gjallesave.
- Në rastet e sëmundjeve të rënda dhe infeksioneve që mund të prekin gjallesat e akuakulturës, gjallesat e ngordhura duhet të pastrohen nga rrjetat dhe të menaxhohen në mjediset tokësore, në bashkëpunim me Bashkinë, duke mos I hedhur ato në det, apo në ambiente tokësore të hapura, pasi mund të kthehen në burime infeksionesh në të dyja mjediset.
- Gjithashtu, është e rëndësishme që investitori duhet të jetë vigjilent ndaj këtyre fenomeneve dhe njëkohësisht ndaj ndotjeve të mjedisit ujor të zonës pasi një ndotje e mjedisit ujor nga persona ose aktivitete të ndryshme, mund të shkaktojë përhapje të ndotjes deri në ujërat e akuakulturës dhe si rrjedhojë mund të krijojë asfiksion të peshqve të cilët në këto kushte nuk mund të shmangen dhe njëkohësisht mund të shkaktojë përqendrim të lëndëve të rrezikshme në organizmin e tyre dhe nëpërmjet zinxhirit ushqimor mund të transmetohet tek njerëzit dhe kafshët, nëse mund të konsumojnë këtë produkt ushqimor.
- Ndotje nga faktorë të tjere të jashtëm të cilët mund të ndikojnë në akuakulturë, mund të kthejë këtë aktivitet në burim ndotjeje gjithashtu, nëse nuk menaxhohet si duhet

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS SI DHE MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis hyn në mardhënie të kushtëzuar ose jo me të, të detyruar ose fakultative, me veprim afatshkurtër ose dhe afatgjatë të cilat duhet të njihen, të vlerësohen, të merren në konsideratë dhe të përcaktohen masat e duhura për minimizimin ose edhe eliminimin e tyre. Kjo ka rëndësi me qëllim që çdo aktivitet jo vetëm të mos e dëmtojë mjedisin por të jetë sa më paqësore me të, madje të influencojë mundësisht pozitivisht në zhvillimin e ekosistemeve natyrore. Praktikisht aktiviteti për kultivimin, rritjen dhe tregëtimin e peshkut nuk shoqërohet me problem mjedisore. Edhe ato pak ndikime mjedisore të vlerësuara si me impakt negativ janë gjate fazës së ndërtimit të vaskave të cilat janë kalimtae dhe tashmë që aktiviteti ka filluar dhe ka shfrytëzuar nje objekt ekzistues, impakti negativ mjedisore thuhet nuk ekziston. Shfrytëzimi i rryetave në kushtet e një regjimi të përpiktë pune nuk sjell asnjë impakt negativ mjedisor.

Në cilesine e ujit dhe faunës

Ky aktivitet është i përqëndruar drejtpërsëdrejti në ujë për pasojë themi se ky është edhe elementi më kryesor që preket nga ky aktivitet.

Lloji i ndikimit në cilësinë e ujit dhe të faunës	Pasojat në mjedis	Masat Zbutëse
Zënia e sipërfaqes ujore	Instalimi i koshave notues për rritjen e kocës dhe levrekut	Subjekti duhet të zbatojë të gjitha afatet e dhënies së lejes së përdorimit për sipërfaqen të ushtrimit të aktivitetit. T'i permbahet kordinatave kufizuese të zonës së dhënë për shfrytëzim
Struktura e vendosjes së koshave	Krijimi i sendimenteve në fundin e tij	Struktura e koshave do të jenë efektive dhe brenda standarteve dhe kodeve ndërkombëtare. Teknologjia do të sigurohet nga kompani të çertifikuara Europiane dhe në përputhje me standartet e BE si nga rezistenca ashtu edhe nga materialet përbërëse. Koshat janë vendosur në thellësi të mjaftueshme ku nuk pengohet qarkullimi ujqor . Koshat janë në mënyrë të tillë që të parandalojnë formimin e mbetjeve fundore. Struktura e koshave janë zgjedhur që t'i rezistojnë kushteve klimatike dhe atyre të detit.

		Janë vendosur shenja dalluese për të shmangur dëmtimet nga shpendët dhe kafshët e ujit
<p>Koncentrate që përdoren për ushqimin e peshkut kanë ndikim negativ të drejtëpërdrejtë në cilësinë e ujit nqs ato nuk janë të çertifikuara.</p> <p>Si agregat të rrezikshëm përmendim këtu metalet e rënda si dhe hormonet nqs ato janë në nivele të larta.</p> <p>Sasia e tepërt e ushqimit dhe substancave të përdorura krijojnë sendimente në kosha.</p>	<p>Koncentratet e çertifikuara kanë në përbërjen e tyre vitamin C,E, proteina, karbohidrate, fosfor etj të cilët ndihmojnë rritjen e peshkut. Nqs ushqimet e jashtme që përdoren për peshkun nuk janë të çertifikuara apo nqs ato përmbajnë metale të rënda bëhen mjaft kërcënues për cilësinë e ujit dhe të peshkut gjithashtu</p>	<p>Subjekti i cili kryen këtë veprimtari duhet të ketë të punësuar një veteriner dhe specialistë që njohin mirë rritjen e peshkut të cilët të përcaktojnë me përpikmeri sasinë e ushqimit që do të përdoret për çdo vakt dhe për çdo grupëmoshë si dhe të tregojnë kujdes të veçantë në përzgjedhjen e ushqimit.</p> <p>Ushqimi i përdorur është i tipit Fulma bounty programi i ushqimit do të varet nga faktorë të tillë si; formula, sasia e ushqimit, metodat e ushqimit, densiteti i hedhjes së ushqimit dhe temperatura e ujit.</p> <p>Koncentratet që përdoren duhet të kenë tretshmëri të lartë.</p> <p>Duhet të zgjidhen ushqime me përbërje sa më të ulët metali pasi ky është një element që mund të reagojë shumë keq në cilësinë e ujit dhe rrjedhimisht në organizmin e peshkut më pas ky reaksion mund të kalojë tek njeriu (reaksion zinxhirë).</p>
<p>Sëmundjet e ndryshme si sëmundjet bakteriale dhe kërpudhore që mund të kapin peshkun nga ushqimi kryesisht si dhe nga mos vaksinimi i rregullt.</p>	<p>Të gjitha këto sjellin pasoja negative në ujë si dhe në rritjen dhe zhvillimin e peshkut në kosha si dhe peshkut e llojeve të ndryshme të botës së gjallë në det.</p>	<p>Të kontrollohen ushqimet si dhe të përdoren vaksina për sëmundjet bakteriale dhe kërpudhore</p>

Mbetjet e ngurta

Lloji i ndikimit Prodhimi i mbetjeve të ngurta	Pasojat në mjedis	Masat zbutëse
Gjenerimi i ambalazheve të ngurta	Prishje e estetikës së ambjentit nga grumbujt e mbetjeve dhe mos caktimi i vend grumbullimit, aroma të pakëndëshme	Mbetjet të cilat gjenerohen nga ky aktivitet janë plastika, qelqet, karton. Kapaciteti i mbetjeve nga ky aktivitet është i ulët ka burim vetëm aktivitetin jetësor të punonjësve si dhe ambalazhet e paisjeve të vogla për mirëmbajtjen e koshave. Për të gjitha këto mbetje sado në sasi të vogël kompania të vendos koshat përkatës për grumbullimin e tyre më pas ti shkarkoj ato në kontejnerët e përcaktuar nga bashkia

Ilacet dhe vaksinat që duhet të përdoren për të ruajtur peshkun dhe cilësinë e ujit

Ilacet të quajtura edhe kimioterapike ose farmaceutike.

Antibiotikë – përdoren për trajtimin e infeksioneve nga sëmundjet bakteriale dhe kërpudhore. Zakonisht përdoren duke u përzier me ushqimin ose ujin.

Vaksina – përdoren për sëmundje të veçanta zakonisht nëpërmjet injeksioneve, do të përdoren nga veteriner të fushës.

Trajtues të ujërave – flokulante për të ulur turbiditetin si gëlqerja e shuar e cila pastron edhe amoniakun

Vitamina – C dhe E, si ushqyes

Ne cilësinë e ajrit dhe tokës

Lloji i ndikimit në ajër	Pasojat në mjedis	Masat zbutëse
Emetim zhurme, gazesh, arome, vibracioni dhe pluhuri	Pasojat në mjedis nga ky ndikim janë mjaftë të ulëta pasi aktiviteti është në fazë funksionimi.	Makinat që përdoren në shërbim të aktivitetit furnizim dhe transport të peshkut drejt tregut, të kontrollohen në mënyrë periodike tek mekaniku vëmendje t'i kushtohet marmitës për uljen e zhurmës, si dhe karburanti i përdorur te jetë cilësorë
Lloji i ndikimit në tokë	Pasojat në mjedis	Masat zbutëse

Ndotja e tokës si pasojë e avarive të makinës ose gjeneratorit	Si pasojë e avarive ose dëmtimi të gjeneratorit ose makinave të punës mund të ketë rrjedhje të lubrifikantëve në tokë, por kjo në sasi mjaft minimale	Të kontrollohen në mënyre të rregullt makineritë tek mekaniku

Ndikimet në mjedisin social - ekonomik

Lloji i ndikimit	Pasojat në mjedis	Masat zbutëse
Projekti ka ndikim pozitiv në komunitet	Punësim dhe rritje të ekonomisë vendase. Punonjësit në këtë aktivitet janë nga zonat perreth	Ndikimet janë pozitive. Subjekti duhet të jetë bashkëpunues me komunitetin

Plani i monitorimit për ushtrimin e aktivitetit për rritjen dhe kultivimin e peshkut do të jetë i vazhduar. Ky plan do të hartohet për të monitoruar parametrat ekologjik dhe biologjik të ujit me qëllim ruajtjen dhe rritjen e efektivitetit të ekosistemeve natyrore dhe të një mjedisi me vlera ekoturistike. Monitoruesi si specialist i këtyre fushave do të kontrollojë e bëjë relacione të vazhdueshme në lidhje me regjimin e punës dhe parametrat ekologjik.

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e komponentëve përkatës.

Në përgatitjen e programit të monitorimit specialistët duhet të marrin në konsideratë mundësinë për të realizuar një monitorim realist të elementëve me ndikim në mjedis.

Të dhënat cilësore subjekti duhet ti hedhë në një regjistër që administrohet nga vetë kompania dhe do të dorëzohen në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit sa here ju kërkohet, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve.

Monitorimi do të konsistoje në:

- Materiali që do të përdoret për ndërtimin dhe instalimin e impiantit të jetë prej lëndëve plastike dhe druri
- Në bazë të kërkesës së ligjit dhe rregullores të kryhen analizat e cilësisë së ujit për parametrat kryesorë.
- Të deklarohet dhe të monitorohet sasia e farës për çdo kosh.
- Peshku para se të ambalazhohet për treg të jetë i kontrolluar nga veterineri.
- Detyrë e domosdoshme është ruajtja e parametrave të cilësisë së ujit nga fenomeni i eutrofisë dhe oligotrofisë. Vetë aktiviteti është me risk për një tendencë të tillë si rezultat i masës organike që del nga popullata e peshqëve gjatë procesit të jashtëqitjes.
- Të monitorohet lloji i ushqimit, përbërësit e tij në element dhe sasi si dhe të monitorohet receta e dhënies për grupmosha të ndryshme.
- Të përdoren medikamente të certifikuara të cilat japin garanci se nuk dëmtojnë gjallesat e tjera të ujit.

- Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë fiziko-kimike të ujit (Temperatura, pH, sasia e O₂).
- Aksidentet teknike me pasoja në mjedis, rrjedhje karburantesh etj.
- Të bëjë kujdes në derdhjen dhe shkarkimin në ujë dhe të monitorohen të gjitha operacionet në ujë.
- Ruajtja me fanatizëm e flores përreth.
- Në rastin e ngordhjes masive (traumautizimin ose infeksionin) duhen bërë menjëherë analizat për të përcaktuar shkaktuesin dhe të merren masa të rrepta përkatëse duke mbajtur të dhëna për mortalitetin .
- Të zbatohen masat karantinore dhe të zbatohet kalendari i masave veterinarë
- Është e nevojshme të kryhet monitorimi i cilësisë së ujit për treguesit NBO₂, O₂, PH, P, edhe të N₂, lëndëve me suspension dhe përqindjes së S, H₂S.
- Të merren masa higjienike për lëvizjen e personelit për të garantuar karantinën e akuakulturës.
- Monitorimi periodik i të gjitha masave të parashikuara për zbutjen e ndikimeve/ Zbatimi i kushteve të Lejes Mjedisore.
- Procesi i monitorimit do të jetë pjesë funksionale e investitorit në bashkëpunim me specialistët përkatës të Drejtorisë Rajonale të Mjedisit, inspektoriatit të Peshkimit, laboratorin veterinarë, drejtorinë e higjienës dhe pushtetin vendorë duke shkëmbyer informacione periodike.

Elementet e monitorimit mjedisor të veprimtarisë

Nr	Elementi i monitoruar	Frekuenca	Shpjegimi
1.	Monitorimi i cilësisë fiziko-kimike të ujit	Vazhdueshme Temp, Ph,NH ₄ ,NO ₂ ,NO ₃ ,Zn..	Subjekti "ALIE – B " do t'i kryej këto analiza pranë "Institutit të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë"
2.	Monitorimi i zonave përreth rrjetave	Periodik Vetëm gjatë kultivimit	Pastrimi i rrjetave, kontrolli i tyre
3.	Monitorimi i sendimentit në rrjeta dhe përreth tyre	Periodik	Sipas analizave. Nuk do të përdoret ushqim. Do të ketë rritje ekstensive
4.	Shmangia e shqetësimit në zonën përreth	Vazhdueshme	Bashkëpunues me komunitetin për çdo shqetësim
5.	Monitorimi i rritjes së levrekut dhe kocës	Periodik	Të kontrollohet çdo etapë e zhvillimit të tyre
6.	Monitorimi i të gjithë masave të parashikuara për zbutjen e ndikimeve / zbatim i kushteve të lejes vendosur në lejen e mjedisit	Periodik	Do të bëhen analiza dhe shqyrtim të efektivitetit të masave të marra.

Rekomandime:

Me qëllim mbarëvajtjen e aktivitetit dhe mbrojtjen e mjedisit rekomandojmë:

- Te ruhen koordinatat e shfrytëzimit të sipërfaqes ujore.
- Rekomandohet që në bazë të ciklit biologjik të zhvillimit dhe rendimentit të metabolizmit të peshkut ai të hidhet për shitje në treg kur të ketë arritur peshën 350-400 gr.
- I rekomandojmë kultivuesit që për vazhdimësi në prodhim dhe rendiment të mbajë parasysh normat e ushqimit ku për tu rritur 1 kg peshk nevojiten 2 kg ushqim i koncentruar.
- Ushqimi i përdorur të jetë i miratuar nga komuniteti evropian dhe të jetë gjithmonë i pajisur me çertifikatë analize, aq e domosdoshme për të mundësuar në të ardhmen daljen në tregun evropian të tregëtimit.
- Ushqimi duhet të ruhet në vende të thata, pa dritë, pa lagështi dhe i ndarë sipas fazave të zhvillimit të peshkut.
- Peshku për 2-3 ditë para se të tregëtohet nuk duhet të ushqehet.
- Të ruhet cilësia e ujit të detit për të mos dëmtuar florën dhe faunën ujore.
- Analizat të kryen në menyrë periodike në laborator të licensuar.
- Në të katër anët e horizontit përreth koshave të vendosen shenja dalluese për mbrojtjen e mjedisit përreth nga ndotja mekanike dhe notropojene.

Investitori do të jetë gjithmonë i hapur për të bashkëpunuar me institucionet e mbrojtjes së mjedisit të cilat do të monitorojnë aktivitetin me qëllim eliminimin e çdo impakti negative në mjedis, sado i vogel qofte ai.

Përgatiti materialin

Ing. ALFRED LAKO
EKSPERT MJEDISI

